



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

VULLNETARIZMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

*Si ta shfrytëzojmë punën vullnetare për
mbrojtjen e trashëgimisë kulturore*

Financuar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij – CHwB, Zyra në Prishtinë





Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

**VULLNETARIZMI DHE
TRASHËGIMIA KULTURORE**
*Si ta shfrytëzojmë punën vullnetare për
mbrojtjen e trashëgimisë kulturore*

Tetor 2009, Prizren & Prishtinë

Botues

Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe – EC Ma Ndryshe

Financuar nga

Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij – CHwB, Zyra në Prishtinë

Disenj, ballina dhe faqosje

Krenar Basha

Shtypi

Night Design Studio

Tirazhi

500 kopje

PËRMBAJTJE

Përmbledhje Ekzekutive
Për projektin
Hulumtimi i parë (metodologjia)

Hyrje

PJESA I – Vullnetarizmi, trashëgimia dhe fondet

Koncepti i Vullnetarizmit
Degradimi i trashëgimisë kulturore në Prizren
Mungesa e fondeve dhe zgjidhjet alternative

PJESA II – Vullnetarizmi në trashëgimi kulturore (dhe kulturë)

Vullnetarizmi dhe kultura
Fokus grupet
Kampet e restaurimit
Vullnetarizmi në Dokufest
Disa rezultate të anketës

PJESA III – Vullnetarizmi, kultura dhe Evropa

Vullnetarizmi në Evropë
Modelet e vullnetarizmit në Evropë
Italia
Gjermania
Britania e Madhe

PJESA IV – Përfundim dhe Rekomandime

Përfundim
Rekomandime

PJESA V – Rezultatet e anketës me interpretime

Literatura

Për EC Ma Ndryshe

Përmbledhje Ekzekutive

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovën e dhjetë viteve të fundit u dëshmuar si një nga angazhimet dhe obligimet më problematike të vendit. Përveç politizimit të skajshëm të çështjes së trashëgimisë kulturore, mungesa e fondeve adekuate (si shtetërore ashtu edhe ndërkombëtare), e kombinuar me prioritetin e ultë që iu dha trashëgimisë kulturore, ndikuan në gjendjen e sotme mjaft të vështirë dhe të degraduar të monumenteve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore. Një nga qasjet dhe zgjidhjet alternative ndaj kësaj gjendjeje të pashpresë, e cila propozohet në këtë analizë ka të bëjë me promovimin dhe shfrytëzimin e punës vullnetare për intervenime direkte me qëllime mbrojtëse.

Rezultatet e anketës së zhvilluar me qytetarët e Prizrenit dëshmojnë se mungesa e iniciativave vullnetare nuk është për tu habitur kur shikohet angazhimi i respondentëve në iniciativa të tilla: vetëm 25% prej tyre kontribuojnë vullnetarisht gjithmonë ose shpesh në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Në anën tjetër, shumë shembuj nga shtete të Evropës dëshmojnë për ndikimin direkt që puna vullnetare ka në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në këtë drejtim, promovimi i punës vullnetare në trashëgimi kulturore ofron një zgjidhje të qëndrueshme për problemet e mëdha me të cilat ballafaqohet trashëgimia kulturore e vendit tonë.

Në bazë të anketës së realizuar, kuptimi i përgjithshëm i termit “Vullnetarizëm” në mesin e qytetarëve të Prizrenit është nga më të ndryshmit. Rreth 1/3 e tyre këtë e kuptojnë si një punë pa kompensim, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme si kohë të lirë (19.1%) dhe hobi (11.3%). Këto të dhëna tregojnë një situatë jo shumë inkurajuese për vullnetarizmin në përgjithësi, duke e ulur qysh në fillim vet konceptin e punës vullnetare për çështje të caktuara të interesit të përgjithshëm dhe duke e zhvendosur rëndësinë e saj poshtë prioritetëve të qytetarëve të Prizrenit. Megjithatë, një pjesë e tyre vullnetarizmin e kuptojnë në një rrafsh më të gjërë, duke e përshkruar si “ndjenjë të përkatësisë” (21.3%) dhe “obligim” (9.2%).

Një përfundim tjetër i anketës dhe i hulumtimit lidhet me paradoksin e bindjeve dhe dëshirës dhe angazhimit konkret të qytetarëve në punë vullnetare. Mungesa e iniciativave vullnetare nuk është për tu habitur kur shikohet angazhimi i qytetarëve në iniciativa të tilla. Vetëm 25% prej tyre kontribuojnë vullnetarisht gjithmonë ose shpesh në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Ndërsa në anën tjetër mbi 80% prej tyre mendojnë se vullnetarizmi kontribuon mesatarisht ose shumë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ky paradoks dhe kjo diferencë në mes të bindjes dhe angazhimit paraqet një ndër shkaqet themelore për përpjekjet e shoqërisë civile për të promovuar punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe për t'i ofruar si qytetarëve ashtu edhe vendimmarrësve alternativa të duhura politike.

Gjithsesi, ky dokument i politikave rekomandon sjelljen e politikave të nevojshme publike si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror për njohjen, promovimin dhe shpërblimin e punës vullnetare, ndërsa paralelisht udhëzon edhe shoqërinë civile si promotore kryesore për arritjen e këtyre qëllimeve, për rrugët që ajo duhet ndjekë në promovimin e vullnetarizmit në nivel lokal, por edhe qendror.

Për projektin

Hulumtimi mbi vullnetarizmin dhe trashëgiminë kulturore është i pari në serinë e hulumtimeve mbi çështje të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, të cilat po i realizon EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit për fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare për vendimmarrje në këtë fushë. Projekti përkrahet financiarisht nga CHWB zyra në Prishtinë dhe paraqet një përpjekje serioze për mobilizimin e aktorëve të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore në komunën e Prizrenit për rritjen e bashkëpunimit mes qeverisë lokale dhe qytetarëve (shoqërisë civile) dhe gjetjen e zgjidhjeve të duhura për sfidat më të mëdha në këtë fushë.

Përveç themelimit të mekanizmave të komunikimit dhe partneritetit të përhershëm dhe të institucionalizuar (Forumi i Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit), projekti synon të avokojë për politika më të mira publike në nivel lokal (por edhe qendror) në trashëgiminë kulturore, përmes serisë së analizave të politikave. Hulumtimi (analiza) pasues i këtij projekti ka të bëjë me intervenimin me kosto të ultë dhe do të jetë një dokument udhëzues (por edhe avokues) për mënyrat e restaurimeve me buxhet të vogël dhe me bashkëpjesëmarrje.

Hulumtimi i parë (metodologjia)

Ky është hulumtimi i parë i serisë së hulumtimeve në kuadër të këtij projekti dhe synon të avokojë për punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore, mbi bazën e rezultateve dhe rekomandimeve të këtij dokumenti të politikave. Për qëllime të këtij hulumtimi është përdorur metoda e hulumtimit sasior ku si instrument kryesor është Pyetëtori i standardizuar që në vete ngërthen pyetje bazë për të matur njohuritë e qytetarëve të Prizrenit mbi gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, mundësitë për tejkalimin e gjendjes së vështirë, punën vullnetare në Prizren, vullnetarizmin në kulturë dhe trashëgimi kulturore dhe potencialin e zhvillimit lokal ekonomik bazuar në vlerat dhe pasuritë kulturore (dhe të trashëgimisë kulturore) të cilat i posedon Prizreni. Në mostrën e hulumtimit janë përfshirë gjithsej 141 pyetësorë me qytetarët e Prizrenit (përqindje statistikisht sinjifikante), derisa hulumtimi ka përdorur edhe dy fokus-grupe për t'i konsultuar aktivistët e shoqërisë civile dhe njohësit tjerë të çështjes së trajtuar. Në hulumtim janë përfshirë qytetarë nga mosha 16-60 vjet, me ndarje 95% qytet dhe 5% fshat, 64.5% të gjinisë mashkullore dhe 35.5% të gjinisë femërore.

Gjinia

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femer	50	35.5	35.5	35.5
	Mashkull	91	64.5	64.5	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

Hyrje

Ndonëse jemi mësuar që temën e trashëgimisë kulturore ta trajtojmë në kontekstin e saj politik, financiar dhe vleror, çështja e vullnetarizmit brenda trashëgimisë kulturore mbetet një aspekt i pandriçuar mjaftueshëm. Në përpjekjet tona, sidomos të shoqërisë civile kosovare, vullnetarizmi paraqitet si një rrugëdalje nga gjendja e vështirë në të cilën është katandisur trashëgimia kulturore e vendit tonë. Dhe këto përpjekje vazhdojnë intensivisht. Ky dokumenti i politikave, ky studim dhe kjo përpjekje tërheq paralele të dëshmuara dhe efektive mes punës vullnetare, përkujdesjes qytetare dhe mobilizimit shoqëror dhe efektit pozitiv që prodhohet për ruajtjes e vlerave, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe përparimin e kauzës së përgjithshme shoqërore të vendit tonë.

Vullnetarizmi është një fenomen shumë i njohur për këdo, por edhe pse larg përpjekjeve për ta karakterizuar atë, mbetet një fenomen interesant dhe kompleks për shoqërinë një pushtet i fortë dhe potencial, i cili është i gatshëm të bëhet aktiv dhe të japë ndihmën e tij njerëzore të cilën e karakterizon, me mjetet e tij, mënyrat dhe kuptimet e tij të veçanta. Vullnetarizmi ka një të kaluar të lashtë të fuqishme, një të tashme vepruese dhe problematike dhe një prespektivë shumë premtuese për të ardhmen. Shoqëria kosovare ka shfaqur nivel të lartë të organizimit, solidaritetit dhe punës vullnetare sidomos gjatë viteve të okupimit, në dekadën kur u rrezikua edhe ekzistenca e kësaj shoqërie. Organizimi shoqëror për mbijetesë dhe kauzë politike ishte i ndërtua mbi bazën e solidaritetit dhe vullnetarizmit, duke prodhuar rezultate të dukshme si në çështjet humanitare, poashtu edhe në drejtime politike dhe civile. Paslufta në Kosovë prodhoi zhvillime të shumta dhe kaotike shoqërore, ndërsa tek çështja e organizimit dhe mobilizimit shoqëror, në përgjithësi u vërejt një ngadalësim dhe largim nga parimet dhe angazhimet me të cilat shquhej kjo shëqori vetëm disa vite më parë. Kjo rënie në kapitalin social të kosovarëve mund të shpjegohet në disa mënyra dhe u shkaktua si bashkëveprim i disa faktorëve determinues. Duke mos dashur të thellohemi në analizën e shkaqeve që sollën këtë rënie në kapitalin social, dëshirojmë që sensin e mobilizimit dhe solidaritetit shoqëror ta promovojmë si një faktor përcaktues për fatin e trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Me pak fjalë, qëllimi ynë përmes shumë përpjekjeve konkrete, njëra nga të cilat është edhe ky dokument i politikave, është që të promovohet puna vullnetare dhe përgjegjësia qytetare për të mbrojtur trashëgiminë tonë kulturore, sidomos në kohëra krizash financiare, por edhe politike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në degradimin dhe shkatërrimin e objekteve dhe vlerave të kësaj trashëgimie.

Në hulumtimin e zhvilluar në qytetin e Prizrenit, qartë shihet një bindje pozitive ndaj punës vullnetare dhe domosdoshmërisë së organizimit dhe përgjegjësisë qytetare për t'u organizuar dhe për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore të qytetit. Megjithatë, vërehet një mospërputhje mes bindjeve dhe veprimeve konkrete të qytetarëve të Prizrenit. Për këtë arsye, është e domosdoshme që shoqëria civile të punojë intensivisht për t'i bindur vendimmarrësit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, që të prodhojnë politike efektive për promovimin, njohjen dhe shpërblimin e punës vullnetare në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, por edhe fushave tjera. Në këtë mënyrë, besojmë që do të zvogëlohet ndjeshëm diferenca mes “dëshirave të mira” dhe “veprimeve konkrete”, me ç'rast vullnetarizmi do të promovohet si rrugëdalje efektive nga situata aktuale e degradimit dhe lënies anash të trashëgimisë sonë kulturore.

PJESA I – Vullnetarizmi, trashëgimia dhe fondet

Koncepti i Vullnetarizmit

Në përgjithësi dhe parimisht vullnetarizmi është praktika e punës së njerëzve, të cilët punojnë për të tjerët pa qenë të motivuar nga përfitimet financiare apo materiale. Vullnetarizmi kryesisht lidhet me një veprimtari altruiste, që ka për qëllim promovimin e cilësisë më të lartë jetësore për njerëzit. Njerëzit poashtu marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare për të përfituar shkathtësi të reja pa patur nevojën e investimeve financiare të punëdhënësit. Vullnetarizmi mund të ketë forma të ndryshme dhe ushtrohet nga grupe të ndryshme njerëzish. Shumë vullnetarë janë të trajnuar në veçanti mbi fushën ku veprojnë, si psh. në mjekësi, arsim apo shpëtim emergjent. Të tjerët marrin pjesë në punë dhe aktivitete vullnetare në bazë të nevojës dhe kërkesës, si psh. duke reaguar ndaj një katastrofe natyrore. Përveç tjerash dhe në parim, njihen tre përfitime të përgjithshme të punës vullnetare (vullnetarizmit): [a] përfitimi ekonomik: aktivitetet që ndërmerren nga vullnetarë, në kushte normale do të duhej të financoheshin nga fondet shtetërore apo private. Vullnetarizmi ndihmon në rezultatet e përgjithshme ekonomike të një shteti dhe zvogëlon ngarkesën mbi shpenzimet qeveritare, [b] përfitimi shoqëror: vullnetarizmi ndihmon ndërtimin e komuniteteve më kohesive, duke nxitur besim më të madh në mes të qytetarëve dhe duke zhvilluar norma të soliaritetit dhe reciprocitetit, të cilat janë genësore për komunitete stabile dhe [c] përfitimi individual (karrieristik): të diplomuarit mund të takojnë njerëz të ndryshëm dhe më përfitojnë përvoja të reja përmes punës dhe aktivitetit vullnetar. Në anën tjetër, vullnetarizmi u ndihmon nxënësve të shkollave për një bursë studimore, duke e ditur rëndësinë e punës vullnetare brenda CV-së.

Fjala angleze vullnetarë fillimisht kuptohej si një ushtar oportunist në një ushtri mesjetare, duke u formuar ngadalë gjatë shekujve në qytetarë të mirë që ne i dimë dhe i duam. Gjuhësia si dhe koncepti ligjor mund të jenë konfuze, sektori i vullnetarëve është duke u rritur në menaxhimin e profesionistëve, dhe shumë vullnetarë duke punuar përtej detit paguhen duke u bazuar në nivelin lokal, ndërsa tjerë janë të lutur të paguajnë për disa privilegje. Fatmirësisht imazhi global i vullnetarizmit ka ndriçuar ndërmjet këtyre varianteve në interpretimet e tyre; vullnetarët janë të përhapur gjerësisht me kohezionin e komuniteteve lokale, duke hedhur poshtë luhatjet e programeve nacionale të mirqënies dhe madje duke çimentuar suksesin e lojtrave olimpikë të Sidneit. Ka me të vërtetë shumë optimizëm në lidhje me fushat e reja të të qenurit vullnetarë që sjell potencialin e zgjerimeve të këtyre sukseseve lokale në fshatin global.

Degradimi i trashëgimisë kulturore në Prizren

Degradimi i trashëgimisë kulturore në Prizren nuk është një konstatim i vështirë shkencor, por tanimë ai është një fakt i gjallë dhe i vazhdueshëm, për të cilin të gjithë ne vazhdojmë të qëndrojmë duarkryq. Jo vetëm gjatë viteve të 1990-ta, por edhe pas luftës, qyteti i Prizrenit ka pësuar goditje nga më të ndryshmet dhe në pikat më të ndieshme të saj, si pasojë e rindërtimit poast-konflikt, urbanizimit kaotik dhe të egër, zhvillimit të pakontrolluar, betonizimit, mosnjohjes me vlerat e trashëgimisë dhe mungesës së përkujdesjes së duhur institucionale. Ky sulm i realizuar në pikën me neuralgjike të qytetit, në trashëgiminë e tij kulturore, është shkak i veprimeve të fundit të shoqërisë civile në Prizren, ku bën pjesë edhe ky dokument. Problemet me trashëgiminë kulturore

të Prizrenit variojnë nga lënia anash e objekteve dhe monumenteve deri tek shkatërrimi i përgjithshëm i tyre. Në ndërkohë, aq shoqëria civile dhe as qeveria lokale nuk janë treguar efektiv në parandalimin e shkatërrimit dhe dita ditës po bëhemi dëshmitarë të rënimit të vlerave të reja, me të cilat ka jetuar ky qytet përgjatë shekujve.

Mungesa e fondeve dhe zgjidhjet alternative

Trashëgimia kulturore në Kosovë sfidohet nga anë të ndryshme, duke filluar nga interpretimet politike, vetëdija e përgjithshme dhe deri tek mundësitë për mbrojtje dhe promovim. Përveç politizimit të skajshëm të çështjes së trashëgimisë kulturore, mungesa e fondeve adekuate (si shtetërore ashtu edhe ndërkombëtare), e kombinuar me prioritetin e ultë që iu dha trashëgimisë kulturore, ndikuan në gjendjen e sotme mjaft të vështirë dhe të degraduar të monumenteve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore. Një nga qasjet dhe zgjidhjet alternative ndaj kësaj gjendjeje të pashpresë ka të bëjë me promovimin dhe shfrytëzimin e punës vullnetare për intervenime direkte me qëllime mbrojtëse. Siç do të shihet edhe nga paraqitja e rasteve të shteteve të ndryshme përgjatë këtij dokumenti, vullnetarizmi është përdorur si rrugëdalje e fundit, që njëherit është dëshmuar si strategji efektive për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të vendit në kushtet e mungesës së fondeve publike, përkujdesjes institucionale, vëmendjes politike, si dhe zhvillimit të pakontrolluar ekonomik.

Nëse analizohet niveli lokal i qeverisjes në Kosovë dhe agjenda institucionale e komunave të Kosovës për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore, atëherë gjendja bëhet edhe më alarmante. Jo vetëm në aspektin e alokimit buxhetor, por edhe në prioritet të politikave publike, sektori i kulturës dhe i trashëgimisë kulturore qëndrojnë shumë larg pozitës që duhet ta kenë realisht. Kur këtij realiteti të dhimbshëm ia shtojmë edhe joprofesionalizmin e administratorëve të kulturës në qeverinë lokale, si edhe mungesën e motivimit të tyre për të punuar në këtë fushë mjaft të ndieshme (sidomos në trashëgimi kulturore), atëherë lehtësisht mund të konkludojmë një situatë të pashpresë për fatin e shumë objekteve dhe monumenteve me vlerë.

Puna vullnetare dhe përgjegjësia e përkujdesja qytetare nuk janë zgjidhje e të gjitha problemeve, ose rrugë e vetme për ta evituar më të keqen në fushën e trashëgimisë, por ato së paku sigurojnë hapin e parë të domosdoshëm dhe porosinë e duhur për qytetarinë që këto përpjekje duhet të masovizohen dhe të shndërrohen në lëvizje të përmasave më të mëdha. Derisa do të vazhdojmë të mendojmë se përkujdesja ndaj trashëgimisë kulturore është punë e shtetit (e në nivel lokal punë e komunës), objektet dhe monumentet tona me vlerë do të vazhdojnë të shkatërrohen si pasojë e shkaqeve të përmendura më lartë. Ndërsa një ditë, kur më në fund do të kuptojmë se është shkaktuar dëm i madh, atëherë problemi mund të jetë i pariparueshëm dhe nuk do të ketë kthim prapa. Thirrja për përkujdesje qytetare ndaj trashëgimisë kulturore të Prizrenit përmes punës vullnetare është thirrja e fundit dhe rrugëdalja e vetme e mbetur në kushtet dhe realitetin aktual politik dhe ekonomik të Kosovës.

PJESA II - Vullnetarizmi në trashëgimi kulturore (dhe kulturë)

Vullnetarizmi dhe kultura

Në vizionin modern mbi shoqërinë, është gjerësisht e pranuar se zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm përmes promovimit dhe zbatimit të marrëdhënieve të shëndosha mes komuniteteve dhe trashëghimisë kulturore: në këtë mënyrë është mjaft e qartë se për të arritur zhvillim ekonomik dhe social, shoqëritë tona kanë nevojë për pjesëmarrje aktive dhe efektive të qytetarëve në këto procese dhe se vetë qytetarët duhet të jenë thellësisht të vetëdijshëm për rolin dhe kuptimin e trashëghimisë kulturore.

Sikurse thuhet shumë shpesh, vullnetarizmi paraqet një resurs shumë të rëndësishëm dhe një tregues kuptimplotë të pjesëmarrjes dhe vetëdijes, si dhe të zhvillimit personal dhe social. Me fjalë të tjera, vullnetarizmi është një nga gurët më të rëndësishëm që e përbëjnë murin kompleks të qytetarisë aktive. Për më tepër, institucionet kulturore, sidomos muzetë, kanë pësuar ndryshime të mëdha kohëve të fundit. Ata prodhojnë shërbime publike dhe kanë një rol social, i cili sot është më i zgjëruar dhe me ndikim krahasuar me kohërat e mëparshme. Institucionet kulturore ballafaqohen me audienca të reja si dhe forma të reja të komunikimit, duke promovuar kohezion dhe përfshirje sociale, si dhe ndërmjetësim kulturor për vizitorët me prejardhje dhe kultura të ndryshme, apo për ata që kanë dituri të ndryshme paraprake dhe përdorin strategji të ndryshme interpretuese. Për këtë arsye, edhe profesionistët e muzeve po ndryshojnë me shpejtësi të madhe, në mënyrë që t'i përgjigjen ndryshimeve ndërkombëtare dhe sociale. Ky ndryshim i përgjithshëm i organizatave dhe kompetencave ndikon drejtpërdrejtë në punën e vullnetarëve brnda organizatave, pasi që edhe rolet dhe detyrat e tyre po bëhen më komplekse.

Ky kompleksitet reflektohet edhe në karakteristikat e ndryshme të vullnetarëve, të cilët nuk mund të konsiderohen si një grup i pandryshueshëm. Vullnetarizmi supozon tipare të ndryshme, gjithnjë në bazë të moshës dhe statusit të vullnetarit, si psh. vullnetarët individualë ose ata që punojnë në kuadër të një organizate; për më tepër, organizatat të cilat punojnë në fushën e kulturës mund të jenë mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra (miqtë e muzeve, shoqatat historike, grupet sociale, etj.)

Pavarësisht këtyre dallimeve, disa organizata ndërkombëtare kanë përcaktuar parime të përgjithshme mbi të drejtat dhe detyrat e vullnetarëve dhe marrëdhëniet e tyre me institucionet ku ata punojnë, në dokumente, të cilët, në të shumtën e rasteve, kanë formën e Kodit të Mirësjelljes.

Në hulumtimin e titulluar “Heritage Counts” në Britaninë e Madhe u anketuan 115 organizata vullnetare dhe grupe tjera që punojnë në trashëgimi kulturore dhe e gjetura e parë na zbulon se numri i vullnetarëve në këtë fushë është mbi 4 milionë, ose rreth 7% i popullatës së përgjithshme të ishullit. Një formë e kontributit të vullnetarëve në trashëgimi kulturore është ndihma financiare, e cila në Britaninë e Madhe kap donacione milionëshe, ndërsa për ta kuptuar më mirë magnitudën e kontributit të përgjithshëm vullnetar në këtë sektor, duhet analizuar rezultatit e punës së njerëzve (vullnetarëve) që punojnë në mënyrë profesionale në kuadër të 115 organizatave ose grupeve vullnetare në

tërë shtetin. Kjo analizë na zbulon se për çdo të punësuar me pagesë në sektorin e trashëgimisë, ekzistojnë rreth 80 vullnetarë, ndërsa ky raport ndryshon nga organizata në organizatë.

Fokus grupet

Në dy fokus grupet e këtij hulumtimi jemi munduar që të masim opinionin dhe t'i përmbledhim rekomandimet e aktivistëve të shoqërisë civile dhe njohësve tjerë të fushës së trashëgimisë dhe vullnetarizmit. Ndonëse qasjet e njerëzve dallonin në pika të caktuara, megjithatë përfundimet e fokus grupeve nxjerrin në pah një fakt: substanca e diskutimeve dhe e përfundimeve mbetet gjithnjë e njëjtë. Konstatimi i përbashkët i pjesëmarrësve të fokus grupeve ishte në drejtim të domosdoshmërisë së punës vullnetare dhe përgjegjësisë qytetare për t'i ndaluar përmasat mjaft të rrezikshme që ka marrë degradimi dhe shkatërrimi i objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Diskutimet u fokusuan edhe në mënyrat e promovimit dhe përhapjes së punës vullnetare tek grupet e gjera shoqërore, me çka do të barteshin përvojat individuale vullnetare në veprime grupore. Vullnetarizmi në Prizren, sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, është konsiderueshëm i përhapur në fusha të caktuara, e ndër ta në ndihmë humanitare, ndihmë personave me aftësi të kufizuara, dhurim të gjakut, pastrim dhe disa sfera tjera. Megjithatë, sikurse dëshmojnë edhe rezultatet e Anketës me qytetarë, aktivitetet vullnetare nuk janë të përhapura sa duhet në fushën e kulturës, e sidomos në trashëgimi kulturore. Marrë parasysh specifikat e qytetit, pjesëmarrësit e fokus grupeve konkluduan se Prizreni, më shumë se në çdo fushë tjetër, ka nevojë për punë vullnetare në mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore.

Kampet e restaurimit

Shumë praktika evropiane por edhe rajonale tashmë kanë dëshmuar për efektivitetin e një instrumenti për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes punës vullnetare. Kampet e restaurimit po dëshmojnë si formë mjaft atraktive për vullnetarët dhe mjaft efektive për qëllime mbrojtëse dhe restauruese. Kjo praktikë e mbrojtjes së objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë po dëshmojnë si një veprim i qëlluar edhe në Kosovë, ndërsa numri i tyre po shkon duke u rritur. Në vazhden e përpjekjeve për të promovuar intervenimin direkt me qëllim mbrojtës, gjithnjë me punë vullnetare dhe kosto sa më të ultë, EC Ma Ndryshe tashmë ka organizuar një numër të kampeve të restaurimit. Këto kampe janë organizuar në fshatin Dranoc të Deçanit, ndërsa pjesëmarrësit e kampeve kanë qenë të rinjtë kosovarë, në raste të caktuara edhe nga grupe të ndryshme etnike, të cilët kanë qenë pjesë përbërëse e intervenimeve direkte me qëllim mbrojtjen e kullave shqiptare të rrezikuara nga moskujdesi, pastrimi dhe rregullimi i rrugëve të fshatit, mbikëqyrja e kopshteve dhe aktivitete të tjera. Të gjitha këto veprime janë ndërmarrë dhe vazhdojnë të realizohen pa kompensim material të vullnetarëve, të cilët punojnë në bazë të vullnetit të tyre të mirë për të kontribuar në trashëgiminë kulturore të vendit.

Vullnetarizmi në Dokufest

Një mobilizim tjetër mjaft i suksesshëm në fushën e vullnetarizmit në kulturë është grupi i vullnetarëve të Festivalit Dokufest në Prizren. Ky festival ka arritur të edukojë një gjeneratë të shëndoshë dhe në hap me kohën të rinjsh, të cilët janë pjesë përbërëse dhe e domosdoshme e organizimit të festivalit. Numri i madh i vullnetarëve të cilët marrin

pjesë në organizimin e Dokufestit çdo vit, e ka bërë këtë organizim të tejkalojë kufijtë e një grupi ad-hoc vullnetar, duke u shndërruar në një lëvizje të përgjithshme të rinjsh të Prizrenit (por edhe të vendeve tjera të Kosovës), të cilët me punën e tyre japin leksion për shumë njerëz, grupe, organizata dhe institucione të Kosovës për mënyrën se si duhet mobilizuar kapacitetet dhe kontribuar vullnetarisht për një aktivitet kulturor, i cili një pjesë të rritjes së tij ia ka borxh vetë vullnetarëve të festivalit.

Disa rezultate të anketës

Po të analizohen disa nga rezultatet e anketës, vërejmë një disponim të përgjithshëm pro punës vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe përfitimeve që sjell mobilizimi i resurseve kulturore për zhvillimin e ekonomisë lokale. Shihet qartë se qytetarët e Prizrenit kanë bindje mjaft pozitive për nevojën dhe domosdoshmërinë e punës vullnetare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por paradoksalisht, të pyetur për involvimin e tyre direkt, ata tregojnë se nuk janë edhe aq aktivisht të angazhuar në punë dhe aktivitete vullnetare në këtë fushë.

1. Sa mund të kontribuojë vullnetarizmi në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Aspak	6	4.3	4.3	4.3
Pak	21	14.9	14.9	19.1
Mesatarisht	53	37.6	37.6	56.7
Shume	61	43.3	43.3	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Qytetarët e anketuar e vlerësojnë vullnetarizmin si një mjet të dobishëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Mbi 80% prej tyre mendojnë se vullnetarizmi kontribuon mesatarisht ose shumë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

2. A ka iniciativa vullnetare në komunitetin tuaj për mbrojtje të trashëgimisë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Aspak	17	12.1	12.1	12.1
Pak	70	49.6	49.6	61.7
Mesatarisht	44	31.2	31.2	92.9
Shume	10	7.1	7.1	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Edhe pse puna vullnetare vlerësohet si shumë e dobishme për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, iniciativat e tilla në Prizren janë të pakta. Shumica e qytetarëve të Prizrenit nuk kanë informata për iniciativat e tilla, gjë që tregon për mungesën e angazhimit qytetar për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, ose në rastin më të mirë për mungesën e promovimit të kësaj pune në rrethin e gjërë të qytetit.

3. A jeni pjese e ketyre iniciativave?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Kurre	31	22.0	22.0	22.0
Rralle	76	53.9	53.9	75.9
Shpesh	26	18.4	18.4	94.3
Gjithmone	8	5.7	5.7	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Mungesa e iniciativave vullnetare nuk është për tu habitur kur shikohet angazhimi i respondentëve në iniciativa të tilla. Vetëm 25% prej tyre kontribuojnë vullnetarisht gjithmonë ose shpesh në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Ky paradoks dhe kjo diferencë në mes të bindjes dhe angazhimit paraqet një ndër shkaqet themelore për përpjekjet e shoqërisë civile për të promovuar punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe për t'i ofruar si qytetarëve ashtu edhe vendimmarrësve alternativa të duhura politike.

A pajtoheni me qendrimin se vullnetarizmi ne trashegimi kulturore mund te prodhoj zhvillim ekonomik per qytetin?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Nuk pajtohem	7	5.0	5.0	5.0
Pajtohem pjeserisht	62	44.0	44.0	48.9
Pajtohem plotesisht	72	51.1	51.1	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Me konstatimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin nuk janë pajtuar vetëm 5% e qytetarëve të anketuar, ndërsa më shumë se gjysma e tyre plotësisht pajtohen me këtë konstatim. Edhe pse kjo pyetje i'u është bërë qytetarëve të rëndomtë, shumica nga të cilët nuk janë pjesë e iniciativave vullnetare për trashëgimi (shih rezultatet e pyetjes 3), vërehet se shumica dërmuese e tyre të paktën e shohin këtë fushë me potencial ekonomik. Edhe pse i pamjaftueshm, ky nivel i vetëdijes mund të shërbejë si një bazë e mirë për ngritjen e iniciativave të ndryshme institucionale dhe civile për materializimin e vlerave të trashëguara dhe punës vullnetare.

PJESA III – Vullnetarizmi, kultura dhe Evropa

Vullnetarizmi në Evropë

Në nivel evropian, roli i vullnetarizmit kohëve të fundit ka fituar mjaft në rëndësi, si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të vështira: në fakt, vullnetarët janë të angazhuar në një sërë aktivitetesh të ndryshme, duke filluar nga ofrimi i shërbimeve edukative dhe sociale, avokimi, menaxhimi, deri tek veprimi komunitar dhe mjedisor. Brenda BE-së, janë ndërmarrë disa hapa në njohjen e vlerës sociale, kulturore dhe mjedisore të vullnetarizmit dhe në përfshirjen e organizatave vullnetare në proceset e vendimmarrjes politike.

“Rezoluta mbi Vullnetarizmin” e miratuar nga Parlamenti Evropian më 1983 e njohu natyrën e interesit të përgjithshëm të veprimtarisë vullnetare, që zhvillimi i një infrastrukture adekuate është qenësore për politika efektive të vullnetarizmit, dhe i bëri thirrje Komisionit Evropian t’i kushtojë vëmendje dhe kujdes sistematik vullnetarizmit. Rezoluta bëri thirrje për një “status për punën vullnetare” për t’i mbuluar shpenzimet dhe sigurimin social për vullnetarët. Deklarata 38 mbi aktivitetet e shërbimit vullnetar, e aneksuar në Traktatin e Amsterdimit, e njeh dhe e vlerëson kontributin e rëndësishëm të aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare për zhvillimin e solidaritetit social, si dhe Komunikata e vitit 1997 e Komisionit Evropian për Promovimin e Rolit të Organizatave dhe Fondacioneve Vullnetare në Evropë thekson rolin e rëndësishëm të vullnetarizmit në krijimin e vendeve të punës. Rishtazi, Komisioni Evropian në një seri dokumentesh ka vlerësuar rëndësinë e një kulture të konsultimit dhe dialogut me organizatat e shoqërisë civile. Një tjetër dokument i rëndësishëm është edhe Deklarata mbi Rolin e Organizatave Vullnetare në Fushën e Trashëgimisë Kulturore, e miratuar nga ministrat përgjegjës për trashëgiminë kulturore të shteteve nënshkruese të Konventës Kulturore të Evropës.

Megjithatë, mbetet shumë punë për të bërë në mënyrë që të afirmohet dhe pranohet gjerësisht vlera ekonomike e vullnetarizmit, në mënyrë që fondet, politikat dhe programet e BE-së të jenë përkrahëse dhe kompatible me nevojat e vullnetarizmit dhe për të krijuar një infrastrukturë adekuate përgjatë Evropës në përkrahje të veprimeve vullnetare. Shumë shtete nuk e përfshijnë vullnetarizmin dhe të dhënat mbi punën vullnetare në statistikat e tyre kombëtare: ndonëse vullnetarizmi nuk nënkupton dhe nuk duhet të nënkuptojë zëvendësim për punën e paguar rregullisht, ai kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmërinë e ekonomive kombëtare. Sipas të dhënave më të reja, miliona qytetarë të Evropës janë të përfshirë aktivisht në aktivitete vullnetare:

- Në Britaninë e Madhe, rreth 23 milionë qytetarë marrin pjesë në aktivitete vullnetare çdo vit, duke ofruar një forcë pune ekuivalente me 180,000 të punësuar me orar të plotë. Vlera ekonomike e vullnetarizmit zyrtar është rreth 8% i BPV-së së Britanisë së Madhe,
- Belgët i kushtojnë 5 orë në javë punës vullnetare pa pagesë, që është ekuivalent me rreth 200,000 të punësuar me orar të plotë,
- Në Francë, koha e kushtuar aktiviteteve vullnetare në vitin 2002 ishte ekuivalente me 716,000 të punësuar me orar të plotë,

- Në Poloni, më 2004, rreth 5.4 milionë qytetarë (18.3% i popullatës) kanë marrë pjesë në aktivitete vullnetare. Vlera e përafërt ekonomike e këtij kontributi vullnetar është 124 milionë euro,
- Në Gjermani, 23 milionë qytetarë (36% i popullatës) janë të përfshirë në aktivitete vullnetare,
- Derisa 33% i popullatës së rritur irlandeze janë të angazhuar në punë vullnetare.

Modelet e vullnetarizmit në Evropë

Ekzistojnë katër modele të vullnetarizmit, të identifikuar nga Archambault, të cilët kanë ndikim mbi kornizën konceptuale dhe operacionale të vullnetarizmit në shumë shtete të Evropës. Një model i pestë është shtuar rishtazi, i cili është relevant për shtetet e ish Bashkimit Sovjetik:

- Në modelin *Rhine* (Austria, Belgjika, Franca, Gjermania dhe Holanda), sektori i vullnetarizmit shquhet me prezencën e organizatave institucionale dhe profesionale, të cilat veprojnë në fusha të ndryshme (kryesisht argëtim, kulturë dhe përkujdesje sociale) në bazë të përkatësisë fetare, politike apo sindikale,
- Në modelin *liberal* (Irlanda dhe Britania e Madhe), sektori i vullnetarizmit ka një rëndësi shumë të fortë simbolike, që i ka rrënjët në parimet e krishterimit socialist të shekullit 19 për të promovuar një ndjenjë të fortë përgjegjësie sociale në mes të klasës së mesme, të lidhur me nocionet e klasës punëtore mbi kulturën kooperative dhe vetë-mjaftueshmëria shoqërore. Këto aktivitete filantropike janë shpesh të organizuara individualisht apo lokalisht, në kundërshtim me ato që promovohen nga qeveria federale (si në SHBA) ose si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në bashkëpunim me komunitetet lokale (në Evropë),
- Modeli *social-demokratik* (Finlanda, Norvegjia dhe Suedia) është i bazuar në një traditë shumë të fortë asociative, e cila më tepër mbështetet mbi rëndësinë e intervenimit të vetëm sesa në përkatësinë ideologjike-fetare,
- Modeli *mesdhetar* (Greqia, Italia, Portugalia dhe Spanja) pasqyron zhvillimin e shpejtë të sektorit të vullnetarizmit në dekadat e fundit, kryesisht si pasojë e mungesës së fondeve publike. Pavarësisht ndryshimeve të fundit, sektori vazhdon të jetë i ndikuar fuqishëm nga roli predominant i Kishës Katolike.
- Modeli i pestë lidhet me *kulturën në rritje të vullnetarizmit*, e cila shfaqet në ish shtetet Sovjetike (komuniste). Në këtë model, vullnetarizmi, në veçantë në trashëgimi kulturore, është në nivel fillestar për shkak të faktorëve të ndryshëm. Kushtet e vështira ekonomike nënkupton që njerëzit duhet të punojnë më gjatë, shpesh më shumë se një punë, duke e shkurtuar kështu kohën e nevojshme për veprimtari vullnetare.

Nëse analizojmë modelet e mësipërme, mund të konkludojmë se Kosova bën pjesë në grupin e pestë dhe pak a shume shfaq elemente të ngjashme me shtetet e dala nga blloku komunist. Në këto shtete, ekziston një mosbesim i vazhdueshëm tek aktivitetet e promovuara nga shteti, që shpesh marrin konotacione të punës kolektive të detyruar, derisa në anën tjetër, mendimi dominant është se të gjitha shërbimet që lidhen me të mirën e përgjithshme, përfshi edhe mbrojtjen e trashëgimisë, duhet të ofrohen nga shteti.

Italia

Ndonëse legjislacioni mbi fushën e kulturës e përmend vullnetarizmin, ky fenomen ka arritur të jetë relevant vetëm në dekadat e fundit, dhe atë jo vetëm si pasojë e rritjes së sasisë së aktiviteteve vullnetare, por edhe si pasojë e cilësisë së lartë të këtyre aktiviteteve. Nevoja për mirëkuptim dhe bashkëpunim më të thellë mes organizatave vullnetare dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore po artikullohet gjithnjë e më fuqishëm në Itali. Organizatat vullnetare janë duke lëvizur drejt kërkesës për t'u njohur si partnerë aktiv në procesin e politikave, vendimeve dhe projekteve që lidhen me fushën e aktivitetit të tyre.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe në veçanti gjatë viteve të 60-ta të shekullit 20, shoqëria civile italiane e artikuloi fuqishëm nevojën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga shkatërrimi i jashtëzakonshëm që shkakohej nga zhvillimi i pakontrolluar ekonomik. Gjatë atyre viteve u themeluan shumë organizata, si Italia Nostra, Grupi i Arkeologëve Italianë, Fondi Italian për Mjedisin, Federata e Miqve të Muzeve, etj. Përkundër ekzistimit të disa formave të koordinimit, bashkëpunimi zyrtar në mes të vullnetarëve dhe sektorit publik filloi më 1991, kur u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit Ministri e Kulturës – Qendra Kombëtare e Vullnetarizmit. Kjo marrëveshje paraqet rezultatin konkret të një qasjeje të re të administratës publike ndaj menaxhimit të trashëgimisë kulturore, që dallohet me njohjen e rolit që vullnetarët mund ta luajnë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në një situatë kronike të mungesës së fondeve dhe menaxhimit të vështirë dhe të dobët të objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë.

Gjermania

Sektori kulturor në Gjermani është i ndarë në një sektor publik të karakterizuar me profesionalizëm dhe një sektor privat të karakterizuar me vullnetarizëm. Derisa muzetë e vogla, private gjithmonë kanë qenë të varur nga vullnetarët, veprimtaria vullnetare në muzetë e mëdha është një fenomen i vonshëm. Që nga vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, muzetë janë ballafaquar me shkurtime buxhetore dhe në të njëjtën kohë, politika dhe shkenca rizbuluan rolin dhe rëndësinë e qytetarisë aktive. Që të dyja këto çështje kanë ndikuar në rritjen e interesimit për vullnetarizëm edhe në kuadër të muzeve të mëdha, të cilët, deri atëherë, mbështeteshin ekskluzivisht tek profesionistët e muzeve dhe fondet publike.

Britania e Madhe

Vullnetarizmi ka një traditë të gjatë në Britaninë e Madhe dhe qëndron mjaft mirë në shumë fusha, përfshi shëndetësinë, mirëqenien sociale, sportin, rininë dhe sektorin e kulturës. Puna vullnetare gëzon përkrahje dhe pranim të gjerë si nga publiku ashtu edhe nga autoritetet vendimmarrëse. Besohet se vullnetarizmi është një nga shtytësit më efektiv të shoqërisë civile në Britaninë e Madhe, duke i siguruar themelet e shoqërisë së hapur të lirë dhe me qytetari aktive. Ndonëse vullnetarizmi është mjaft i përhapur në sektorin kulturor, nuk ekziston ndonjë rrjet formal i organizatave vullnetare të trashëgimisë. Shumë organizata ombrellë fokusohen në vullnetarizmin përbrenda fushës së tyre të ngushtë. Kontributi më i madh në këtë fushë jepet nga Këshilli i Muzeve, Librarive dhe Arkivave, agjencia shtetërore e Britanisë së Madhe për muzetë, galeritë, libraritë dhe arkivat, duke ofruar lidhshmëri strategjike dhe partneritet në tërë ishullin.

PJESA IV – Përfundim dhe Rekomandime

Përfundim

Krahasuar me vitet e 1990-ta, kosovarët sot shfaqin një nivel mjaft të ultë të mobilizimit shoqëror. Kjo rënie në kapitalin social të kosovarëve reflektohen në shumë fusha dhe atë mjaft negativisht. Përveç problemeve të mëdha sociale me të cilat ballafaqohen shoqëria jonë, një nga elementet që gjithnjë e më shumë po neglizhohet në këtë realitet të rëndë social është edhe kultura, konkretisht trashëgimia kulturore. Situatë më të rëndë për trashëgiminë kulturore të një vendi nuk mund të ketë, se sa kjo që e kemi sot. Në situatën aktuale, janë kombinuar faktorët më të rëndë, duke filluar nga politizimi i trashëgimisë e deri tek mungesa e fondeve publike, për të krijuar një pasqyrë të dhimbshme dhe mjaft të pashpresë për vlerat e këtij vendi. Kjo situatë është veçanërisht alarmante në qytetin e Prizrenit, i cili shquhet me numrin e madh të objekteve, monumenteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore.

Tani për tani është e qartë se nuk është e afërt dita kur trashëgimia kulturore do të depolitizohet, duke u kthyer në agjendën politikëbërëse, dhe kur mungesa e fondeve për mbrojtje do të zëvendësohet në alokime meritore të mjeteve buxhetore, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal qeverisës. Për këtë arsye, në një situatë të këtillë kufizuese dhe të pashpresë, ashtu siç sugjeron edhe ky dokument, puna vullnetare dhe mobilizimi shoqëror paraqet rrugëdaljen e vetme nga qorrsoakaku në të cilin është katandisur trashëgimia jonë. Qytetaria aktive është baza e një shoqëria të hapur dhe të shëndoshë, e cila merret vetë me problemet e veta, pa prituri shumë nga shteti apo nga aktorët e tjerë të jashtëm. Trashëgimia kulturore është pikërisht një nga ato fushat, respektivisht problemet më të ndieshme të këtij vendi, për çka kërkohet mobilizim shumë i gjerë qytetar dhe marrje e fatit në duart tona. Përderisa të vazhdohet me këtë neglizhencë të rrezikshme ndaj trashëgimisë, shoqëria jonë do t'i humb vlerat e saj civilizuese, duke qenë vetë shkaktar i degradimit dhe shkatërrimit të këtyre vlerave, si pasojë e mosveprimit.

Pas përfundimit të proceseve shtetndërtuese dhe formimit të institucioneve shtetërore në nivel lokal dhe qendror, vendi ynë posedon me të gjitha mundësitë dhe resurset për t'i ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Një nga këto veprime, që nuk lidhet vetëm me trashëgiminë, është njohja, promovimi dhe shpërblymi i punës vullnetare, me çka do të nxiteshin shumë individë dhe organizata të shoqërisë civile apo grupe tjera të organizuar, që të jenë më aktivë dhe të kontribuojnë seriozisht me punë vullnetare. Në fushën e kulturës, vullnetarizmi, siç shihet edhe nga prezantimi i shteteve të BE-së, është një ndër faktorët determinues për mirëqenien e sektorit, ndërsa në shumë raste puna vullnetare është përdorur si strategji dalëse nga situatat kur mungesa e fondeve i rrezikonte objektet dhe vlerat e trashëgimisë. Paralelisht, shoqëria civile, sidomos në nivel lokal, duhet të ofrojë shembuj konkretë të aktivitetit vullnetar duke krijuar mundësi pjesëmarrjeje edhe për të tjerët. Një nga detyrat madhore të shoqërisë civile në këtë situatë është avokimi direkt tek vendimmarrësit në nivel qendror dhe atë lokal për krijimin e legjislacionit adekuat për vullnetarizmin, ndërsa paralelisht duhet angazhuar në krijimin dhe zbatimin e politikave efektive publike,

sidomos në nivel lokal për të prpmovuar punën vullnetare dhe krijuar partneritete funksionale mes shoqërisë civile dhe qeverisë lokale.

Nga anketa e realizuar me qytetarët e Prizrenit, vërejmë qartë një bindje të theksuar dhe pajtueshmëri të përgjithshme për rëndësinë dhe rolin e punës vullnetare në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Megjithatë, të pyetur për angazhimin e tyre në punë vullnetare, qytetarët e Prizrenit nuk kishin shumë përvoja për të na treguar. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se gatishmëria e qytetarëve për punë vullnetare duhet të kanalizohet duke e nxitur me politika dhe programe konkrete, të cilat janë oglimim i përbashkët i qeverisë qendrore, komunave dhe shoqërisë civile. Kur bëhet fjalë për rolin e institucioneve në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, qytetarët mendojnë që shoqëria civile është ajo që duhet të jetë prijëse e këtij procesi. Lidhja e vullnetarizmit (jo vetëm në këtë fushë) me shoqërinë civile rezulton jo e befasishme, për shkak të perceptimit të përgjithshëm që puna vullnetare dhe shoqëria civile janë dy pjesë të asociuara në mes vete. Komuna rezulton segmenti i dytë që ka përgjegjësi për të nxitur vullnetarizmin në trashëgimi kulturore, përkundër përgjegjësive dhe kompetencave që gëzon. Pas qeverisë, e cila renditet e treta, bizneset janë vlerësuar që kanë më së paku përgjegjësi në nxitjen e punës vullnetare për trashëgimi kulturore. Ky vlerësim bie ndesh me vlerësimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin, për shkak që në rast të një zhvillimi të tillë bizneset do të ishin ato që do të përfitonin më së shumti. Kjo, në logjikën e shëndoshë, duhet t'i nxisë bizneset që të jenë ndër iniciatorët kryesorë të promovimit të punës vullnetare në trashëgimi kulturore.

Në bazë të rezultateve të anketës, iniciativat nga OJQ-të rezultojnë të jenë faktorët kryesorë nxitës për angazhimin e qytetarëve në punë vullnetare për trashëgimi kulturore. Kjo edhe është dëshmuar përgjatë viteve të fundit si e vërtetë në praktikë, në raste të ndryshme të aktiviteteve të organizuara nga OJQ të ndryshme. Indiferenca e përgjithshme politike dhe sociale e popullësisë duket se është reflektuar edhe në këtë segment, përkundër traditës dhe frymës qytetare të aktivizmit në komunitet të qytetarëve prizrenas gjatë të kaluarës. Njohja zyrtare e punës vullnetare, sikurse është vlerësuar me raporte të shumta edhe në fusha tjera, është faktor mjaft i rëndësishëm në nxitjen e qytetarëve për angazhim vullnetar edhe në trashëgimi kulturore. Ndërkohë, siç konstaton edhe hulumtimi, papunësia dhe gjendja e vështirë ekonomike paraqesin pengesë të madhe në angazhimin vullnetar të qytetarëve. Ky vlerësim bie ndesh me disa nga vlerësimet tjera të po të njejtëve qytetarë. Nëse vullnetarizmi në trashëgimi kulturore paraqet potencial për zhvillim ekonomik; nëse koha e lirë përbën një pjesë domethënëse për angazhim në punë vullnetare; dhe nëse trashëgimia kulturore paraqet një prioritet të lartë për qytetin e Prizrenit, atëherë logjika e shëndoshë do të na jepte rezultate të kundërta. Puna vullnetare do të duhej të shihej si një mjet shumë efikas në zvoglimin e papunësisë dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të qytetarëve të Prizrenit. Përfundimisht duhet ta luftojmë paradigmen e pasivitetit qytetar si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike dhe sociale, dhe të kuptojmë se renditja është anasjelltas: nuk jemi të zhvilluar pikërisht se kemi qytetari pasive dhe inerte.

Rekomandime

Në bazë të rezultateve të anketës, analizës mbi rolin e vullnetarizmit në trashëgimi, rasteve të shteteve të BE-së dhe praktikës së përgjithshme të vullnetarizmit, EC Ma Ndryshe rekomandon këto veprime dhe për këta aktorë:

Për qeverinë qendrore

- Përgatitja e ligjit mbi vullnetarizmin dhe procedimi i menjëhershëm në Parlament. Ligji do të njihte zyrtarisht punën vullnetare, duke e promovuar dhe shpërblyer vullnetarizmin
- Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit qeveri – shoqëri civile (tashmë të nënshkruar), përfshirja e një aneksi për promovim të vullnetarizmit
- Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe organizatave kulturore dhe vullnetare, për promovimin e vullnetarizmit në kulturë dhe trashëgimi kulturore

Për qeverinë lokale

- Përfshirja e çështjes së vullnetarizmit në agjendën zyrtare të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe financimi i programeve për promovimin e vullnetarizmit
- Miratimi i Rregullores mbi punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore, me të cilin do të krijoheshin grupe vullnetarësh që do të bënin mbikëqyrjen e objekteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të qytetit
- Nxitja e bashkëpunimit qeveri lokale – shoqëri civile – komunitet i biznesit, për promovim të vullnetarizmit dhe krijim të mundësive të reja për punë vullnetare

Për shoqërinë civile

- Avokim direkt tek vendimmarrësit lokal dhe qendror për përfshirje të çështjes së vullnetarizmit në agjendën zyrtare institucionale
- Mobilizim i potencialit të organizatave të shoqërisë civile për ta kanalizuar atë në punë vullnetare, si nxitje edhe për grupet tjera qytetare
- Kampanjë vetëdijesuese për rolin e vullnetarizmit në shoqërinë demokratikë, dhe veçanërisht për domosdoshmërinë e veprimit vullnetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Për komunitetin e biznesit

- Pjesëmarrja në programet e partneritetit mes qeverinë lokale dhe shoqërinë civile për të krijuar hapësirë dhe mundësi për punë vullnetare dhe kontrobut për komunitetin
- Promovim i konceptit të prgjegjesisë sociale të korporatave, duke e shprehur vullnetin e mirë të bizneseve për përkujdesje ndaj shoqërisë
- Tolerimi i të punësuarve me orar të plotë për të kryer punë vullnetare pa e patur frigën e ndëshkimit ose zbritjes së rrogës

Për donatorët dhe organizatat ndërkombëtare

- Dizajnimi i skemave speciale të grant-dhënies për promovimin e vullnetarizmit, sidomos në nivel lokal
- Përkrahje organizatave të shoqërisë civile në avansimin e agjendës së tyre për njohjen zyrtare të punës vullnetare.

PJESA V – Rezultatet e anketës me interpretime

1. Sa mund të kontribuojë vullnetarizmi në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid				
Aspak	6	4.3	4.3	4.3
Pak	21	14.9	14.9	19.1
Mesatarisht	53	37.6	37.6	56.7
Shume	61	43.3	43.3	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Qytetarët e anketuar e vlerësojnë vullnetarizmin si një mjet të dobishëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Mbi 80% prej tyre mendojnë se vllnetarizmi kontribuon mesatarisht ose shumë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

2. A ka iniciativa vullnetare në komunitetin tuaj për mbrojtje të trashëgimisë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid				
Aspak	17	12.1	12.1	12.1
Pak	70	49.6	49.6	61.7
Mesatarisht	44	31.2	31.2	92.9
Shume	10	7.1	7.1	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Edhe pse puna vullnetare vlerësohet si shumë e dobishme për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, iniciativat e tilla në Prizren janë të pakta. Shumica e qytetarëve të Prizrenit nuk kanë informata për iniciativa të tilla, gjë që tregon për mungesën e angazhimit qytetar për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, ose në rastin më të mirë për mungesën e promovimit të kësaj pune në rrethin e gjërë të qytetit.

3. A jeni pjesë e ketyre iniciativave?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid				
Kurre	31	22.0	22.0	22.0
Rralle	76	53.9	53.9	75.9
Shpesh	26	18.4	18.4	94.3
Gjithmone	8	5.7	5.7	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Mungesa e iniciativave vullnetare nuk është për tu habitur kur shikohet angazhimi i respondentëve në iniciativa të tilla. Vetëm 25% prej tyre kontribuojnë vullnetarisht gjithmonë ose shpesh në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Ky paradoks dhe kjo diferencë në mes të bindjes dhe angazhimit paraqet një ndër shkaqet themelore për përpjekjet e shoqërisë civile për të promovuar punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe për t'i ofruar si qytetarëve ashtu edhe vendimmarrësve alternativa të duhura politike.

4.1 Ne çfare objektesh te trashegimise kulturore keni kontribuar me aktivitet vullnetar koheve te fundit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Xhami	53	37.6	46.1	46.1
	Kishe	6	4.3	5.2	51.3
	Shtepi	28	19.9	24.3	75.7
	Ure	6	4.3	5.2	80.9
	Kala	8	5.7	7.0	87.8
	Hamam	7	5.0	6.1	93.9
	Tjeter	7	5.0	6.1	100.0
	Total	115	81.6	100.0	
Missing	System	26	18.4		
Total		141	100.0		

Edhe në rastet kur qytetarët vlerësojnë se kanë kontribuar në ndonjë aktivitetet vullnetar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, shumica e këtij aktiviteti kufizohet në pjesë shumë personale të tyre. Më shumë se gjysma janë angazhuar në punë vullnetare në shtëpitë dhe objektet e tyre fetare. Objektet “publike” të trashëgimisë kulturore kanë përfituar nga aktiviteti vullnetar i qytetarëve vetëm në më pak se 20% të rasteve, gjë që në njëfarë mase e arsyeton shkallën e ultë të njohurisë së qytetarëve për iniciativat ekzistuese. Gjithashtu vërehet edhe kufizimi i këtij aktiviteti vetëm në objektet më të njohura të qytetit, duke lënë anash një numër shumë të madh të objekteve tjera të trashëgimisë kulturore të cilat nuk janë shumë të ekspozuara në publikun e gjërë. Kjo e dhënë e bën shqetësuese situatën e promovimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në qytetin e Prizrenit, duke filluar nga mungesa e shenjëzimit të këtyre objekteve e deri te përkujdesja institucionale dhe qytetare ndaj tyre.

5.1 Ne çfare vlerash te trashegimise kulturore keni kontribuar me aktivitet vullnetar koheve te fundit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Folklor	15	10.6	15.8	15.8
	Muzike	36	25.5	37.9	53.7
	Kuzhine	19	13.5	20.0	73.7
	Rrefime	25	17.7	26.3	100.0
	Total	95	67.4	100.0	
Missing	System	46	32.6		
Total		141	100.0		

Përveç objekteve, trashëgimia kulturore e Prizrenit është e pasur edhe me vlera tjera. Qytetarët e Prizrenit duket se më së shumti angazhohen për ruajtjen dhe kultivimin e muzikës, si vlerë e traditës qytetare. Edhe pse nuk janë bërë matje të opinionit publik, festivali i muzikës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit” dhe publiciteti që ka në mbarë Kosovën, mund të jetë një ndër arsytet e këtij angazhimi më të madh, në krahasim me vlerat tjera të trashëgimisë kulturore.

A pajtoheni me qendrimin se vullnetarizmi ne trashegimi kulturore mund te prodhoj zhvillim ekonomik per qytetin?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Nuk pajtohem	7	5.0	5.0	5.0
	Pajtohem pjeserisht	62	44.0	44.0	48.9
	Pajtohem plotesisht	72	51.1	51.1	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

Me konstatimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin nuk janë pajtuar vetëm 5% e qytetarëve të anketuar, ndërsa më shumë se gjysma e tyre plotësisht pajtohen me këtë konstatim. Edhe pse kjo pyetje i'u është bërë qytetarëve të rëndomtë, shumica nga të cilët nuk janë pjesë e iniciativave vullnetare për trashëgimi (shih rezultatet e pyetjes 3), vërehet se shumica dërmuese e tyre të paktën e shohin këtë fushë me potencial ekonomik. Edhe pse i pamjaftueshm, ky nivel i vetëdijes mund të shërbejë si një bazë e mirë për ngritjen e iniciativave të ndryshme institucionale dhe civile për materializimin e vlerave të trashëguara dhe punës vullnetare.

7.1 Renditni sipas pergjesisë (1-5) aktoret e meposhtem qe kane rol ne nxitjen e vullnetarizmit ne mbrojtje te trashegimise kulturore?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Komuna	34	24.1	24.1	24.1
	Shoqeria civile	60	42.6	42.6	66.7
	Biznesi	11	7.8	7.8	74.5
	Qeveria	30	21.3	21.3	95.7
	Tjeter	1	.7	.7	96.5
	Ref/Pp	5	3.5	3.5	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

7.2 Renditni sipas pergjesisë (1-5) aktoret e meposhtem qe kane rol ne nxitjen e vullnetarizmit ne mbrojtje te trashegimise kulturore?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Komuna	45	31.9	31.9	31.9
	Shoqeria civile	17	12.1	12.1	44.0
	Biznesi	13	9.2	9.2	53.2
	Qeveria	24	17.0	17.0	70.2
	Ref/Pp	42	29.8	29.8	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

7.3 Renditni sipas pergjesisë (1-5) aktoret e meposhtem që kanë rol në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Komuna	20	14.2	14.2	14.2
Shoqëria civile	23	16.3	16.3	30.5
Biznesi	28	19.9	19.9	50.4
Qeveria	22	15.6	15.6	66.0
Ref/Pp	48	34.0	34.0	100.0
Total	141	100.0	100.0	

7.4 Renditni sipas pergjesisë (1-5) aktoret e meposhtem që kanë rol në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Komuna	4	2.8	2.8	2.8
Shoqëria civile	16	11.3	11.3	14.2
Biznesi	44	31.2	31.2	45.4
Qeveria	24	17.0	17.0	62.4
Ref/Pp	53	37.6	37.6	100.0
Total	141	100.0	100.0	

7.5 Renditni sipas pergjesisë (1-5) aktoret e meposhtem që kanë rol në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore? Tjeter

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	137	97.2	97.2	97.2
Donator të jashtëm	1	.7	.7	97.9
OJQ	1	.7	.7	98.6
Pasaniket	1	.7	.7	99.3
Presioni dhe financimet ndërkombetare	1	.7	.7	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Kur bëhet fjalë për rolin e institucioneve/sectorëve të caktuar në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, qytetarët mendojnë që shoqëria civile është ajo që duhet të jetë prijëse e këtij procesi. Lidhja e vullnetarizmit (jo vetëm në këtë fushë) me shoqërinë civile rezulton jo e befasishme, për shkak të perceptimit të përgjithshëm që puna vullnetare dhe shoqëria civile janë dy pjesë të asociuara në mes vete. Komuna rezulton segmenti i dytë që ka përgjegjësi për të nxitur vullnetarizmin në trashëgimi kulturore, përkundër përgjegjësive dhe kompetencave që gëzon. Pas qeverisë, e cila renditet e treta, bizneset janë vlerësuar që kanë më së paku përgjegjësi në nxitjen e punës vullnetare për trashëgimi kulturore. Ky vlerësim bie ndesh me vlerësimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin (shih rezultatet e pyetjes 6), për shkak që në rast të një zhvillimi të tillë bizneset do të ishin ato që do të përfitonin më së shumti. Kjo, në logjikën e shëndoshë, duhet t'i nxisë bizneset që të jenë ndër iniciatorët kryesorë të promovimit të punës vullnetare në trashëgimi kulturore.

8.1 Cilet jane faktoret nxitës për ju, që të angazhoheni për punë vullnetare për trashëgimë kulturore?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Iniciativa e OJQ-ve	62	44.0	44.0	44.0
Njohja zyrtare e punës vullnetare	43	30.5	30.5	74.5
Reduktim i taksave	10	7.1	7.1	81.6
Degradimi i trashëgimise kulturore	22	15.6	15.6	97.2
Ref/Pp	4	2.8	2.8	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Duke qënë në përputhje me vlerësimin e pyetjes së kaluar, iniciativat nga OJQ-të rezultojnë të jenë faktorët kryesorë nxitës për angazhimin e qytetarëve në punë vullnetare për trashëgimë kulturore. Kjo edhe është dëshmuar përgjatë viteve të fundit si e vërtetë në praktikë, në raste të ndryshme të aktiviteteve të organizuara nga OJQ të ndryshme. Përkundër vlerësimin të përgjithshëm për degradimin e trashëgimisë kulturore të qytetit të Prizrenit (vlerësim nga hulumtime të kaluara të bëra nga EC Ma Ndryshe), kjo shërben si nxitje për angazhim vullnetar vetëm të një pjesë shumë e vogël e qytetarëve. Indiferenca e përgjithshme politike dhe sociale e popullsisë duket se është reflektuar edhe në këtë segment, përkundër traditës dhe frymës qytetare të aktivizimit në komunitet të qytetarëve prizrenas gjatë të kaluarës. Njohja zyrtare e punës vullnetare, sikurse është vlerësuar me raporte të shumta edhe në fusha tjera, është faktor mjaft i rëndësishëm në nxitjen e qytetarëve për angazhim vullnetar edhe në trashëgimë kulturore.

9.1 Si e kuptoni termin "Vullnetarizem"?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Obligim	13	9.2	9.2	9.2
Punë me kompensim	8	5.7	5.7	14.9
Punë pa kompensim	42	29.8	29.8	44.7
Hobi	16	11.3	11.3	56.0
Kohe e lire	27	19.1	19.1	75.2
Ndjenje e perkatesise	30	21.3	21.3	96.5
Ref/Pp	5	3.5	3.5	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Kuptimi i përgjithshëm i termin "Vullnetarizem" në mesin e qytetarëve të Prizrenit është nga më të ndryshmit. Rreth 1/3 e tyre këtë e kuptojnë si një punë pa kompensim, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme si kohë të lirë (19.1%) dhe hobi (11.3%). Këto të dhëna tregojnë një situatë jo shumë inkurajuese për vullnetarizmin në përgjithësi, duke e ulur qysh në fillim vet konceptin e punës vullnetare për çështje të caktuara të interesit të përgjithshëm dhe duke e zhvendosur rëndësinë e saj poshtë prioriteteve të qytetarëve të Prizrenit. Megjithatë, një pjesë e tyre vullnetarizmin e kuptojnë në një rrafsh më të gjërë, duke e përshkruar si "ndjenjë të përkatësisë" (21.3%) dhe "obligim" (9.2%).

10. Sa jeni vullnetare, si qytetare te Prizrenit?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Aspak	13	9.2	9.2	9.2
Pak	58	41.1	41.1	50.4
Mesatarisht	54	38.3	38.3	88.7
Shume	16	11.3	11.3	100.0
Total	141	100.0	100.0	

11. A eshte trashegimia kulturore prioritet ne raport me ceshtjet tjera qe e preokupojne Prizrenin?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Po	85	60.3	60.3	60.3
Jo	50	35.5	35.5	95.7
Tjeter	1	.7	.7	96.5
Ref/Pp	5	3.5	3.5	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Duke qenë në vijë me epitetet e ndryshme të qytetit të Prizrenit për vjetërsinë dhe traditën e tij, qytetarët e Prizrenit e vlerësojnë trashëgiminë kulturore si prioritet të qytetit (60.3%).

12. Sa e njihni trashegimine kulturore te qytetit (Prizrenit)?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Aspak	6	4.3	4.3	4.3
Pak	26	18.4	18.4	22.7
Mesatarisht	71	50.4	50.4	73.0
Shume	38	27.0	27.0	100.0
Total	141	100.0	100.0	

Njohja e trashëgimisë kulturore të qytetit nga vet qytetarët e Prizrenit konsiderohet e mirë. Shumica prej tyre (77.4%) mendojnë që i njohin mesatarisht ose shumë objektet dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në qytet. Nëse angazhimi i tyre për mbrojtjen e këtyre vlerave mund të mirret si një matës i kualitetit të njohjes së tyre, atëherë kjo njohje e relativizon rëndësinë e saj, duke mos i përkthyer informatat dhe dijen për to në angazhim për ruajtjen dhe promovimin e tyre.

13. Cilat kategori moshash duhet te angazhohen ne vullnetarizem per trashegimine kulturore?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rinia	102	72.3	72.3	72.3
	Mes-mosha	34	24.1	24.1	96.5
	Pleqte	3	2.1	2.1	98.6
	Ref/Pp	2	1.4	1.4	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

Rinia zë vendin kryesor në punën vullnetare për trashëgimi kulturore, sipas qytetarëve të Prizrenit, e përcjellë menjëherë nga mes-mosha. Përkundër rëndësisë së pakontestueshme të angazhimit të rinisë në këtë fushë, duke pasur parasysh edhe përqindjen e madhe të tyre në popullësinë e përgjithshme, vlerësimi shumë i ulët për angazhimin e moshës së shtyer në trashëgimi kulturore (vetëm 2.1%) e bën njohurinë dhe përvojën e kësaj shtrese të popullësisë të pashfrytëzuar sa duhet.

4. Sa paraqet pengese papunesia dhe gjendja ekonomike ne angazhimin tua vullnetare?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	13	9.2	9.2	9.2
	Pak	25	17.7	17.7	27.0
	Mesatarisht	30	21.3	21.3	48.2
	Shume	73	51.8	51.8	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

Papunësia dhe gjendja e vështirë ekonomike paraqesin pengesë të madhe në angazhimin vullnetar të qytetarëve. Ky vlerësim bie ndesh me disa nga vlerësimet tjera të po të njejtëve qytetarë. Nëse vullnetarizmi në trashëgimi kulturore paraqet potencial për zhvillim ekonomik; nëse koha e lirë përbën një pjesë domethënëse për angazhim në punë vullnetare; dhe nëse trashëgimia kulturore paraqet një prioritet të lartë për qytetin e Prizrenit, atëherë logjika e shëndoshë do të na jepte rezultate të kundërta. Puna vullnetare do të duhej të shihej si një mjet shumë efikas në zvoglimin e papunësisë dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të qytetarëve të Prizrenit.

15. A ekziston (funksionon) ndonje grup i vullnetareve ne qytetin e Prizrenit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	81	57.4	57.4	57.4
	Jo	8	5.7	5.7	63.1
	Nuk e di	52	36.9	36.9	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

16. Sa eshte e nevojshme qe Prizreni te kete grupe te vullnetareve rreth ceshtjeve te ndryshme?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	1	.7	.7	.7
	Pak	10	7.1	7.1	7.8
	Shume	129	91.5	91.5	99.3
	Ref/Pp	1	.7	.7	100.0
	Total	141	100.0	100.0	

Përfundimisht, rëndësia e punës vullnetare në qytetin e Prizrenit vlerësohet lartë. Mbi 90% të qytetarëve të anketuar mendojnë që Prizreni ka nevojë të madhe për grupe të vullnetarëve rreth çështjeve të ndryshme. Kjo nevojë, duke u kombinuar me hapësirën e madhe për përmirësim të gjendjes jo vetëm në trashëgimi kulturore, është një element shtesë për angazhimin e të gjithë faktorëve relevantë në promovimin e punës vullnetare për të mirën e komunitetit në përgjithësi.

Literatura

Dervishi, Zyhdi, *Vullnetarizmi, ind shumëfunksional i shoqërisë*. albPAPER, Tiranë 2005

Quaedvlieg-Mihailovic, Sneska and Graf Strachwitz, Rupert (eds.), *Heritage and the Building of Europe*. Europa Nostra and Kulturstiftung Haus Europa, Berlin 2004

Gunyon, Bill, *Gjuha e vullnetarit – kohë për vigjilencë*. OneWorld

Mediaj, Bajram, *Vllnetarizmi në legjislacionin shqiptar*.

Gibbs, Kirsten dhe Sani, Margherita (eds.), *Volunteering in Museums and Cultural Heritage: A European Overview*. European project Volunteers for Cultural Heritage (VoCH), Tetor 2008

Archambault, Edith, *Le bénévolat en France et en Europe*. Centre National de la Recherche Scientifique, 2006

Wikipedia, Volunteering - <http://en.wikipedia.org/wiki/Volunteering>

Parlamenti Evropian, *Rezoluta mbi Vullnetarizmin*. 1983

Komisioni Evropian, *Komunikata për Promovimin e Rolit të Organizatave dhe Fondacioneve Vullnetare në Evropës*. 1997

Ministrat përgjegjës për trashëgiminë kulturore të shteteve nënshkruese të Konventës Kulturore të Evropës, *Deklarata mbi Rolin e Organizatave Vullnetare në Fushën e Trashëgimisë Kulturore*. 2001

Për EC Ma Ndryshe

Organizata Jo-Qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua ne Mars të vitit 2006, nga një grup të rinjësh, kryesisht prizrenas, me përvojë në sektorin jo-qeveritar dhe atë privat. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse, ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore, avancimi i pozitës së rinisë në proceset vendim-marrëse, promovimi i drejtësisë sociale dhe kontribuimi në proceset e integritit të Kosovës në strukturat evropiane nëpërmjet vlerave kulturore, shoqërore, qytetare dhe politike të vendit tonë.

Nëpërmjet punës vullnetare, EC Ma Ndryshe kishte për qëllim kryesor ndryshimin e qasjes së qytetarëve të Prizrenit dhe më gjërë, ndaj vlerave të përbashkëta dhe çështjeve të cilat i takojnë komunitetit. Pjesëmarrja qytetare ishte koncepti themelor i aktivitetit të organizatës, i cili me kohë u fokusua në trashëgimi kulturore dhe kulturë, si dhe kontribut në procesin integrimi europiane. Përveç 13 anëtarëve themelues, qysh në vitin e parë EC Ma Ndryshe mobilizoi një grup të madh vullnetarësh (kryesisht nxënës të shkollave të mesme) të cilët u angazhuan në aktivitetet e saj, sikurse edhe aksione të ndryshme qytetare jashtë ombrellës zyrtare të organizatës.

Në vitin 2007 EC Ma Ndryshe zgjeroi aktivitetin e saj edhe jashtë qytetit të Prizrenit, ndërsa hapi zyre edhe në Prishtinë, pas angazhimit në një numër projektsh të nivelit qendror. Qasja pjesëmarrëse e punës së organizatës ndikoi që EC Ma Ndryshe të krijojë raporte të mira bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe atë qendror, sidomos në aspektin e kontributit në nxitjen e debatit gjithëpërfshirës për çështje të caktuara dhe hartimin e politikave kulturore. Përveç nxitjes së presionit qytetar, ofrimi i alternativave për zgjidhjen e problemeve të caktuara dhe implementimi i tyre ka bërë që EC Ma Ndryshe të jetë partner i besueshëm i qytetarëve dhe vendim-marrësve.

OJQ EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage, rrjet ky udhëheqës në rajon i kësaj fushe. Gjithashtu, është themeluese dhe udhëheqëse e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, forum ky ku rregullisht takohen të gjithë aktorët relevantë qeveritarë, jo-qeveritare dhe të sektorëve tjerë të fushës nga qyteti i Prizrenit. EC Ma Ndryshe është edhe pjesëmarrëse e rregullt e Forumit për Trashëgimi Kulturore të Kosovës, udhëhequr nga MKRS.

Bazuar në fushat e veprimtarisë së saj, EC Ma Ndryshe ka bashkëpunim të shkëlqyer me organizatat dhe donatorët që merren me trashëgimi kulturore dhe kulturë (CHwB, ATTA, DokuFest, Teatri Oda etj.) dhe integrimi europiane (KCSF, KFOS, EUIRC etj.). Përveç personelit të organizatës (2 punëtorë me orar të plotë pune dhe 2 të tjerë më gjysëm orar), EC Ma Ndryshe ka një rrjet të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët vazhdimisht angazhohen në përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe implementimin e projekteve të ndryshme.

Projektet kryesore

Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009) – qëllimi kryesor i kërrij projekti është krijimi i parakushteve elementare për forcimin e

veprimet qytetar për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore në Kosovë, përmes një seti të veprimeve dhe masave konkrete, me synim mobilizimin e aktorëve kryesor institucional dhe civil për t'i adresuar sfidat dhe politikat zhvillimore në fushën e trashëgimisë kulturore

Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009) – forcimi dhe zhvillimi i politikave kulturore të lidhen me procesin e integritimit evropian dhe arritja e pjesëmarrjes së plotë të Kosovës në Programin Kulturor 2007 – 2013 të DGEC (EU Directorate General for Education and Culture).

Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009) – Deri tani, EC Ma Ndryshe ka organizuar një numër të konsiderueshëm kampesh restaurimi, në të cilët ka kombinuar aktivitete të intervenimit direkt me pjesën e edukimit dhe ngritjes së aftësive të pjesëmarrësve, kryesisht mbi çështjet e vullnetarizmit në trashëgimi kulturore.

Forumet e Hapura Qytetare (2007) – nxitja e kulturës së debatit në Prizren mbi çështjen e rëndësisë vitale për qytetin, respektivisht mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të qytetit dhe rritjen e vetëdijes së përgjithshme për nevojën dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes, kultivimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore so një potencial për zhvillimin e turizmit kulturor në Prizren.

Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 and 2008) – EC Ma Ndryshe ka qenë aktivisht e përfshirë në organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, në partneritet me organizatat tjera jo-qeveritare dhe institucionet shtetërore.

Zambaku i Prizrenit 2006 – në natën e 7 korrikut 2006, në kopshtin veror të kinemasë Lumbardhi në Prizren, në prezencë të rreth 700 spektatorëve dhe në transmetim të drejtpërdrejtë të Radio Televizionit të Kosovës, EC Ma Ndrysha ka organizuar festivalin e këngës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit”.

Publikimet

Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008) – qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë informata relevante dhe të domosdoshme për organizatorët (partnerët) e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, në mënyrë që Kosova të demonstrojë profesionalizëm dhe pajtueshmëri me standardet evropiane të organizimit dhe shënimit të ditëve të trashëgimisë.

Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008) – ky publikim është produkt i projektit “Forumet e Hapura Qytetare” dhe përbëhet nga i) përfundimet dhe rekomandimet kryesore nga debatet, ii) të gjeturat e anketës, dhe iii) analiza mbi potencialin e turizmit kulturor në Prizren.

Foto katalogu “Prizreni diku dhe sot” – në këtë prezantim krahasues të qytetit, paraqiten dy fytyrat e Prizrenit, duke i ofruar lexuesit mundësinë e identifikimit të ndryshimeve marramendëse që kanë ndodhur në qytet, përmes krahasimit të fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit.

Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009) – ky është publikimi i parë i serisë së publikimeve në kuadër të projektit “Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore” dhe ka për qëllim ofrimin e rekomandimeve konkrete mbi mënyrën e shfrytëzimit të punës vullnetare për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore.